Mal Berisha

Botuar në TIRANA DIPLOMAT – 23.09.2023

MARJANA GOXHABELLIU - NJË ZË I LIRË NË TELAJO – PËRTEJ KUFIJVE TË ARTIT TË MËSUAR

MARJANA GOXHABELLIU - NJË ZË I LIRË NË TELAJO – PËRTEJ KUFIJVE TË ARTIT TË MËSUAR

Botuar në TIRANA DIPLOMAT – 23.09.2023
Nga Mal Berisha

Më 21 shtator, në ambjentet e Galerisë së Arteve të Tiranës, u çel ekspozita personale e artistes Marjana Goxhabelliu – një zë krejtësisht i veçantë, origjinal dhe i lirë në botën e artit shqiptar.

Veprat e saj pasqyrojnë një univers të ri estetik, një përmasë tjetër të perceptimit, që shkëputet nga klishetë e artit tradicional dhe sfidon konturet e ngurta të akademizmës së zakonshme. Ato duken si pasqyra të një bote që e jetojmë sot – dinamike, e papërkufizueshme, shpesh e papritshme.

Ajo pikturon me frymën e lirë të atij që nuk është skllav i formulave, dogmave, apo recetave të dhëna. Ndoshta pikërisht sepse nuk ka ndjekur rrugën klasike të shkollimit në artet figurative, Marjana krijon siç ndjen – jo siç duhet. Kjo i jep veprës së saj një frymë të natyrshme, intuitive dhe të fuqishme. Ajo eksperimenton pa frikë, duke ndjekur vetëm talentin dhe shpirtin e saj krijues.

Kjo nuk përbën një shkëputje nga trashëgimia, por një pasurim të saj. Veprat e Marjanës nuk imitojnë askënd, nuk ndjekin hijet e të tjerëve. Ato qëndrojnë më vete – të pangjashme, të sinqerta, të gjalla.

Këtë origjinalitet e hasëm edhe këtë herë në ekspozitën e saj, por e hasim vazhdimisht: në atelienë ku lindin veprat, në murin ku varën për t'u soditur, brenda dhe jashtë Shqipërisë, në galeri apo shtëpi private – gjithmonë të kërkuara dhe të vlerësuara.

Dallohet menjëherë në punët e saj një raport i menduar me ngjyrën. E verdha – ajo ngjyrë që mbart dritën, zgjuarsinë dhe idenë – është një element që shfaqet me forcë në pikturat e Marjanës, duke shpërfaqur një mendim të qartë estetik dhe një intuitë të mprehtë për balancën vizuale.

Ekspozita u ndanë me skulpturat e mjeshtrit të njohur Idriz Balani – një tjetër kontribut i vyer për ngjarjen artistike.

Urime të përzemërta për Marjanën dhe gjithë sukseset në rrugën e saj krijuese, që vazhdon të mahnitë e të frymëzojë.

REPLAY

Levi's

together
Ekspozitë e përbashkët
IDRIZ BALANI
MARJANA GOXHABELLIU (JANABELA)
21
18:00
ORARI I VIZITAVE
10:00 - 18:00
OPENING HOURS
TUESDAY - SUNDAY
10:00 - 18:00
GALERIA E ARTIT TIRANË
GALERIA E ARTIT TIRANË